



## **Shqiptim i Vendimit mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe Provave**

**(KSC-CC-PR-2017-01)**

**26 prill 2017**

### **Hyrje**

Shpall hapjen e seancës të nxjerrjes së Vendimit të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në çështjen e Referimit të Rregullores së Procedurës dhe të Provave në bazë të nenit 19(2) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar të Kosovës ('Ligji').

Kryetarja e Dhomave të Specializuara, gjykatësit e seancës plenare dhe publiku, përgjithësisht janë informuar në kohë për datën dhe kohën e kësaj seance.

Seancën plenare e cila nxori këtë Referim e kryesoi Kryetarja e Dhomave të Specializuara të cilës në emër të panelit të Gjykatës Kushtetuese i uroj mirëseardhjen.

### **Procedura**

Rregullorja e Procedurës dhe e Provave e cila rregullon funksionimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës, u miratua prej gjykatësve të Dhomave të Specializuara të mbledhur në seancë plenare ("Plenarja"), më 17 mars 2017 ('Rregullorja').

Më 27 mars 2017, Rregullorja iu referua Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ('Gjykata') në përputhje me nenin 19(5) të Ligjit ('Referimi').

Duke u bazuar në nenin 33(3) të Ligjit, për shqyrtimin e Rregullores u caktua një panel prej tre (3) gjykatësish të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu u caktua edhe një gjykatës rezervë.

### **Historiku procedural**

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese u formua në kuadër të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe nëpërmjet shqyrtimit të kushtetutshmërisë së Rregullores së Procedurës dhe të Provave ushtron kompetenca mbikëqyrëse mbi Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, dhe rrjedhimisht shërben si garantues shtesë i Kushtetutës.

Referimi iu dorëzua Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese më 27 mars 2017 dhe nga ajo datë, Gjykata kishte 30 ditë për shqyrtimin e Rregullores, për të garantuar përputhshmërinë e saj me Kapitullin II të Kushtetutës.

Më 29 dhe 30 mars 2017, dhe më 10, 11, 22 dhe 23 prill 2017, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese zhvilloi kuvendime, në privatësi, në lidhje me Rregulloren e miratuar nga Plenarja.



Tani do t'u paraqes një përmbledhje të shkurtër të Aktvendimit që Gjykata miratoi sot, më 26 prill 2017, dhe më pas, do të lexoj dispozitat vendimore të tij.

Kjo përmbledhje nuk është pjesë e Aktvendimit dhe nuk është detyruese për Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese. Një kopje e kësaj përmbledhjeje do të vihet në dispozicion në fund të kësaj seance.

Teksti i plotë i aktvendimit do të vihet në dispozicion dhe mund të lexohet në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

### **Çështja**

Çështja që iu referua Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ngre pyetjen nëse Rregullorja e Procedurës dhe e Provave, e miratuar nga Plenarja, është në përputhje me Kapitullin II, përfshirë nenin 55, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kapitulli II i Kushtetutës trajton të drejtat dhe liritë themelore.

Fillimisht, Gjykata konstatoi se Referimi ishte i pranueshëm, sepse ishte bërë në përputhje me Ligjin.

Për shqyrtimin e Rregullores, Gjykata u bazua në nenin 19(2) të Ligjit, i cili kërkon që Rregullorja të pasqyrojë standardet më të larta të të drejtave të njeriut, me synim garantimin e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë. Gjykata e interpretoi çdo rregull mbi bazën e gjuhës konkrete të tekstit, ashtu siç ishte miratuar nga Plenarja.

Për aq sa ishte e mundshme, gjatë shqyrtimit të Rregullores Gjykata zbatoi doktrinën e 'interpretimit harmonik'. Kudo ku kuptimi i drejtpërdrejtë i tekstit e lejonte një gjë të tillë, Gjykata procedoi mbi bazën e arsyesimit se dispozita e një rregulle të veçantë nuk duhet interpretuar e shkëputur nga pjesët e tjera të Rregullores, por përkundrazi, duhet të interpretohet në harmoni me to.

Në rast se një rregull trajtonte një çështje të të drejtave themelore të njeriut, të garantuara me Kushtetutë, rregulla u shqyrtua në imtësi dhe tërësi, me qëllim që të përcaktohej përputhshmëria e saj e përgjithshme me Kapitullin II të Kushtetutës. Në interpretimin e dispozitave të Kushtetutës për të drejtat e njeriut, Gjykata ka mbajtur parasysh nenin 53 i cili parashtron se dispozita të tilla duhen interpretuar në një mënyrë që është në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### **Konstatimet**

Pas shqyrtimit të 208 rregullave të miratuara nga Plenarja, Gjykata konstatoi se nëntë rregulla ishin në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës. Gjykata nuk arriti të nxirrte konstatim në lidhje me një rregull tjetër. Si rrjedhojë, për 198 rregulla u konstatua se nuk ishin në mospërputhje me Kushtetutën.

Rregullat për të cilat Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese konstatoi se ishin në mospërputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës ishin si vijon:



### **Rregulla 19(3)**

Për aq sa kjo rregull lejonte që seancat të vijonin të zhvilloheshin në prani të dy anëtarëve të një paneli, në mungesë të anëtarit të tretë të tij, Gjykata arriti në përfundimin se një seancë e tillë nuk ishte seancë përpara një gjykate të themeluar me ligj, siç e kërkon neni 31.2 i Kushtetutës. Arsyet e këtij konstatimi parashtrohen në Aktvendim, por në thelb përqendrohen në çfarë kërkon Ligji lidhur me përbërjen e paneleve të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

### **Rregullat 31, 32 dhe 33**

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese konstatoi se rregullat 31, 32 dhe 33 janë në mospërputhje me të drejtën themelore të privatësisë sipas nenit 36 të Kushtetutës, sikurse cilësohet nga neni 55 i saj. Këto rregulla parashikojnë autorizimin e masave hetimore të posaçme, përfshirë përgjimin e komunikimeve private. Sipas mendimit të Gjykatës, ato nuk përmbanin garancitë e kërkuara minimale mbrojtëse që janë të domosdoshme sipas standardeve më të larta të ligjit për të drejtat e njeriut. Rregullat nuk përcaktonin kategoritë e personave për të cilët mund të zbatoheshin masat; atyre u mungonte saktësia e mjaftueshme lidhur me kohëzgjatjen e përgjimit të komunikimeve dhe përmbanin garanci të pamjaftueshme lidhur me mbajtjen dhe asgjësimin e të dhënave të marra si rrjedhojë e këtyre masave. Gjykata konstatoi se këto rregulla në formën që ishin miratuar, nuk përmbushnin kërkesën e ‘cilësisë së ligjit’ sipas nenit 55 të Kushtetutës dhe nuk mund të demonstrojnë se ‘ndërhyrja’ e lejuar ishte brenda konceptit ‘e domosdoshme’ në një shoqëri demokratike.

### **Rregulla 35(1) dhe rregulla 35(3)**

Rregulla 35 parashtron procedurën e kontrollimit dhe sekuestrimit që kryhet nga Prokurori i Specializuar në mungesë të autorizimit paraprak nga gjykata. Gjykata konfirmoi se kërkohet një kornizë e qartë ligjore dhe vendosja e kufijve të rreptë mbi këto kompetenca, për mbrojtjen e personave nga ndërhyrja arbitrare prej autoriteteve, me të drejtën e respektimit të privatësisë të mbrojtur nga Kushtetuta. Gjykata konstatoi se kompetencat e dhëna Prokurorit të Specializuar prej rregullës 35(1)(b) dhe 35(1)(c) ishin tejet të zgjeruara dhe nuk përmbushnin kërkesat e ‘domosdoshmërisë’ të parashikuara në nenin 36.2 të Kushtetutës.

Gjykata gjithashtu konstatoi se rishikimi gjyqësor *ex post facto* i përcaktuar në rregullën 35(3), nuk parashikonte përfshirjen e një vlerësimi mbi proporcionalitetin e masës dhe, si rrjedhojë, nuk e kufizonte efektin e kontrollimeve dhe sekuestrimeve të sipërpërmendura brenda konceptit ‘e domosdoshme’ në një shoqëri demokratike.

### **Rregulla 36(1) dhe rregulla 36(2)**

Rregulla 36 ka të bëjë me ekzekutimin e operacioneve të kontrollit dhe sekuestrimit. Gjykata konstatoi se rregulla 36(1) dhe rregulla 36(2) nuk ishin formuluar me shkallën e kërkuar të saktësisë për sa i përket zbatueshmërisë dhe përdorimit të tyre. Për këtë arsye, ato nuk



plotësonin kërkesën e cilësisë së ligjit që është pjesë e pandarë e termit “me ligj”, siç parashikohet në nenin 55.1 të Kushtetutës.

### **Rregulla 38(1) dhe rregulla 38(5)**

Rregulla 38 përcaktonte ekzaminimin mjeko-ligjor për mbledhjen e mostrave trupore, si qimet, pështymën, mostrat e gjakut, ADN-së dhe materialeve të tjera të ngjashme. Rrjedhimisht, kjo rregull trajton të drejtat e paprekshmërisë fizike dhe të privatësisë sipas nenit 26 dhe 36 të Kushtetutës.

Rregulla 38(1) përcaktonte kompetencën e Prokurorit të Specializuar për të urdhëruar mbledhjen dhe ekzaminimin prej ekspertëve të mostrave të qimeve, pështymës dhe mostrave të tjera të cilat mund të merren pa ndërhyrje trupore. Gjykata konsideroi se, në lidhje me lejen e parashikuar në këtë dispozitë për marrjen e mostrave të qimeve, pështymës, ose mostrave të tjera nga një person (në dallim nga një objekt me të cilin personi ka qenë në kontakt), marrja e tyre nuk mund të bëhej pa ndërhyrje trupore, sado e vogël qoftë kjo ndërhyrje. Në mungesë të garancive të mjaftueshme për rrethanat kur një person nuk ka dhënë pëlqimin për marrjen e mostrave të qimeve, pështymës, ose mostrave të tjera, Gjykata konstatoi se rregulla 38(1) ishte në mospërputhje me kërkesën e “domosdoshmërisë” sipas nenit 55.2 të Kushtetutës.

Gjykata gjithashtu konstatoi se rregulla 38(5) ishte në mospërputhje me Kushtetutën sepse parashikonte mbajtjen, për një kohë të konsiderueshme, të të gjitha materialeve, përfshirë edhe mostrat qelizore të mbledhura nga një person, pa bërë ndonjë vlerësim të veçantë të domosdoshmërisë së tyre sipas rrethanave konkrete në secilin rast. Gjykata konstatoi se mbajtja e mostrave të tilla trupore nuk vendoste një baraspeshë të drejtë ndërmjet interesave konkurruese publike dhe private përkatëse, në shkelje të nenit 55.4 të Kushtetutës.

### **Rregulla 54**

Rregulla 54 përmban dispozita për rishikimin dhe rishqyrtimin e mbajtjes në paraburgim. Gjykata konstatoi se rregulla 54(4) kërkonte një shqyrtim të imët dhe qartësim të mëtejshëm. Në një lexim të drejtpërdrejtë, dispozita e bën lirimin e një personi të paraburgosur krejtësisht të varur nga pëlqimi i një shteti të tretë, edhe në rrethanat kur një panel ka vendosur se ekzistojnë arsye të mjaftueshme që kërkojnë lirimin e të paraburgosurit. Gjykata konstatoi se, në pamje të parë, kjo dispozitë specifike e rregullës 54(4) ishte në mospërputhje me nenin 29 të Kushtetutës.

### **Rregulla 158(2)**

Rregulla 158(2) trajtonte mbajtjen në paraburgim të një personi që ishte shpallur i pafajshëm pas gjykimit. Gjykata konstatoi se mbajtja e mëtejshme në paraburgim e një personi të shpallur të pafajshëm nuk parashikohet me ligj dhe nuk përfshihet në një prej arsyeve të lejueshme për privimin e lirisë. Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se kjo dispozitë ishte në mospërputhje me Nenin 29 të Kushtetutës.



### **Rregulla 134(3)**

Për arsyet e paraqitura në Aktvendimin e saj, Gjykata nuk mundi të nxirrte konstatim nëse rregulla 134(3) ishte në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

### **Data e hyrjes në fuqi**

Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

### **Dispozita vendimore**

Pasi kam dhënë një përmbledhje të shkurtër të shqyrtimit të Gjykatës, tani do të lexoj dispozitat vendimore të Aktvendimit, me anë të të cilave Gjykata:

1. *Shpall* njëzëri se Referimi është i pranueshëm;
2. *Vlerëson* njëzëri se rregullat 31, 32, 33, 35(1)(b) dhe (c) dhe 35(3), 36(1) dhe (2), 38(1) dhe (5), dhe 54(4) janë në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës;
3. *Vlerëson*, me shumicë, se rregullat 19(3) dhe 158(2) janë në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës;
4. *Vlerëson*, njëzëri se nuk është në gjendje të shpallë se rregulla 134(3) është në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës; dhe
5. *Vlerëson* njëzëri se dispozitat e tjera të Rregullores nuk janë në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

Këtu përfundon seanca e pasdites dhe rrjedhimisht e deklaroj të mbyllur.

/nënshkrim/

Gjykatëse An Pauër Ford

Kryesuese



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA